



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

MBI PROCEDURAT, KOSTOT DHE AFATET KOHORE PER MBYLLJEN E FONDEVE TË INVESTIMEVE

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 129, datë 06.10.2011

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurën, kostot dhe afatet kohore për mbylljen e një fondi investimesh.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 108, paragrafi 3, të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, (këtu e më poshtë “Ligji”).

Neni 3

Emërimi i likuiduesit

1. Likuiduesi i një fondi investimi mund të jetë vetëm një person, i cili përmbush kërkesat për pozicionin e anëtarit të këshillit të administrimit të një shoqërie administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të përcaktuar në Ligj.
2. Likuiduesi do të informojë Autoritetin për të gjitha aktivitetet lidhur me mbylljen e një fondi investimesh çdo 1 (një) javë, ose më shpesh nëse e kërkon Autoriteti.
3. Likuiduesi i një fondi investimi menjëherë pas marrjes së pozicionit të likuiduesit, dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga fillimi i procedurave të mbylljes, do të hartojë dhe dorëzojë në Autoritet raportet financiare fillestare të mbylljes dhe raportin për gjendjen e fondit, si dhe planin për procedurat e mëtejshme të mbylljes duke përfshirë edhe propozimin për shpërndarjen e pasurisë të fondit, si dhe raportet përfundimtare financiare të mbylljes dhe raportin e procedurave të tjera të mbylljes.

Neni 4

Mbyllja e fondit të investimit

1. Gjatë procedurave të mbylljes, veprimtaria e biznesit në vijim do të ndërpritet. Transaksionet me asetet e fondit do të lejohen vetëm për qëllimet e mbylljes së fondit.
2. Vlera neto e aseteve të mbetura të fondit do të paguhet për mbajtësit e kuotave jo më vonë se brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e marrjes së vendimit për shpërndarjen e vlerës së aseteve të mbetura të fondit.
3. Kur paguhet vlera neto e aseteve të mbetura të fondit për mbajtësit e kuotave, këta të fundit do të kenë akses në raportet financiare të procedurave të mbylljes.
4. Pasi vlera neto e aseteve të mbetura të fondit të jetë shpërndarë tek mbajtësit e kuotave, likuiduesi do të dorëzojë në Autoritet raportet përfundimtare të mbylljes së fondit dhe raportin e transaksioneve të kryera të mbylljes.
5. Pasi procedurat e mbylljes së fondit të kenë përfunduar, likuiduesi do të depozitojë të gjitha librat zyrtare të biznesit të fondit të mbyllur në Autoritet.
6. Rregullat e zbatuara për fondet e investimeve për hartimin e raporteve vjetore do të zbatohen njësoj për hartimin e raporteve fillestare dhe përfundimtare financiare gjatë procesit të mbylljes.
7. Pas marrjes së vendimit të mbylljes, fondi i investimit do të ketë shtesën “në procedurë mbylljeje”.
8. Pasi procedurat e mbylljes së fondit të kenë përfunduar, mbarimi i mbylljes së një fondi investimi do të regjistrohet në regjistrin e fondeve pranë AMF-së.

Neni 5

Kufizimet kohore për realizimin e mbylljes së fondit të investimit

1. Afati kohor për të realizuar mbylljen e një fondi investimi do të jetë deri në 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së vendimit për mbylljen e fondit.
2. Në rastin kur likuiduesi i një fondi investimi vendos që është në interesin e kreditorëve dhe mbajtësve të kuotave për të shtyrë afatin kohor referuar paragrafit 1 të këtij Neni, likuiduesi, në vijim të raporteve referuar në paragrafin 3, të nenit 3 të kësaj rregulloreje dhe të planit për procedurat e mbylljes, do të dorëzojë në Autoritet shpjegimin për shtyrjen e afatit kohor për realizimin e procedurave të mbylljes, afat i cili nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

Neni 6

Kostot e mbylljes së fondit të investimit

1. Pas datës së marrjes së vendimit për mbylljen e një fondi investimi, fondi nuk mund të ngarkohet me tarifa për depozitarin, kosto të lidhura me procedurat e mbylljes dhe për

kontrollin e mbylljes dhe kostot e hartimit dhe dorëzimit të raporteve gjashtëmuajore ose vjetore të kontrollit për investitorët e fondit, të cilat lindin gjatë procedurave të mbylljes.

2. Likuiduesi i një fondi investimi ka të drejtë të përfitojë rimbursim të përshtatshëm të shpenzimeve dhe pagesës profesionale, i cili do të përcaktohet me vendim të Autoritetit. Rimbursimi i shpenzimeve dhe pagesa profesionale për likuiduesin e fondit do të kryhen nga asetet e fondit përpara se asetet e fondit të shpërndahen tek mbajtësit e kuotave.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI